




MIK I MONUMENTEVE



MBROJ



DREJTORIA RAJONALE E KULTURËS KOMBËTARE, BERAT

Ceremonia e shpalljes së projektit “Miqhtë e Monumenteve”

09.30 - 10.00

Dr. i DRKK-Berat Z. Eugen KALLFANI

Dr. i DAR-Berat Z. Selman HODAJ

Dr. i QMK-Berat Z. Agron POLOVINA

Nënshkrimi i protokollit të bashkëpunimit në fushën e trashëgimisë dhe edukimit për projektin “Miku i Monumentit” ndërmjet DRKK dhe DAR - BERAT

10.00 – 10.15 Ekspozitë fotografike “Monumentet e Beratit”

10.15 – 11.00 Vizitë në Muzeun Etnografik (Guidë)

11.10 – 11.20 Takim me Ambasadorët e Mjedisit.

Në drejtimin e vullnetarëve të Korpusit të Paqes nëpërmjet Ambasadorëve të Mjedisit dhe nxënësve të shkollave të ndryshme të Beratit, organizohet një fushatë sensibilizuese për pastrimin e Kalasë Berat.

11.30 – 12.00 Ekspozitë me Piktorët e Vegjël

Piktura më e vlerësuar nga specialistët e Artit do të shoqërohet me një çmim simbolik.

Në këtë ditë të shënuar të Trashëgimisë Kulturore, DRKK-Berat ofron guida në itineraret turistike.

DREJTORIA RAJONALE E KULTURËS KOMBËTARE VLORË

Aktivitete me nxënësit e shkollave në:

- 1) Kalanë e Kaninës,
- 2) P.A. Orik,
- 3) P.A. Amantia,
- 4) P.A. Finiq,
- 5) Në Manastirin e Zvërnecit
- 6) Kisha e Dyzet Shenjtorëve
- 7) Bazilika dhe Sinagoga,
- 8) Manastirin e Shen Nikolles

si dhe bashkëbisedime me nxënësit dhe mësuesit në kuadrin e nismës 'Miqtë e Monumentit', shoqëruar me videoprojektor.

DREJTORIA RAJONALE E KULTURËS KOMBËTARE DURRËS

Programi i aktiviteteve, për nder të Ditës Ndërkombëtare të Monumenteve e Siteve, 18 Prill.

Aktiviteti do të nisë në orën 12.30 në Amfiteatrin e Durrësit, ku do të nënshkruhet protokoli i bashkëpunimit midis DRKK dhe DAR, Durrës.

Organizatore e aktivitetit është Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare, Durrës, me pjesëmarrjen e:

- Ministres së Kulturës, Mirela Kumbaro,
- Ministres së Arsimit dhe Sportit, Lindita Nikolla,
- Kryetarit të Bashkisë së Durrësit, Vangjush Dako,
- DAR,Durrës, autoritete të tjera lokale, miq e të ftuar.

Ceremonia e dhënies së shkollave në birësim:

Të gjitha shkollat që do të aderojnë fillimisht në projektin “Mik i Monumentit”, do të përfaqësohen me grupimin përkatës të nxënësve që janë bërë vullnetarisht pjesë e procesit të birësimit, me mësuesin koordinator ne krye. Do të shpallet fillimi i projektit, i cili do të marrë përmasa më të mëdha më pas, duke përfshirë shkolla dhe qytete të tjera dhe nxënësit do të marrin publikisht përgjegjësitë në lidhje me monumentin.

- Nxënësit do të jenë të pajisur me T-shirte dhe logon përkatëse, çdo shkollë do të ketë tabelën e saj me emrin e shkollës dhe të monumentit përkatës.
- Administratorja e Trashëgimisë Jomateriale të DRKK dhe përfaqësuesit e shkollave me radhë marrin në dorëzim monumentet, një nxënës përfaqësues i shkollës merr certifikatën e dhënies në adoptim, me “çelësin” simbolik të monumentit. Kjo do të bëhet për të gjitha shkollat (jane 8 shkolla) që do të aderojnë në procesin e adoptimit.

DREJTORIA RAJONALE E KULTURËS KOMBËTARE SHKODËR

Aktivitetet e datës 18 prill:

Në bashkëpunim dhe koordinim me DAR Shkodër do të shpërndahen postera për të sensibilizuar nismën.

- Ora 10-00 te porta e Rozafatit, hapja , prezantimi i rëndësisë dhe ditës së 18 prillit dhe nismës 'Miqte e Monumenteve'.
- 10.15 minuta do të lëvizet në brëndësi të kalasë, ku një grup nxënësish do të bëjnë pastrimin e hyrjes dhe oborrit të parë të kalasë.
- 10.45 minuta një grup muzikor do të performojë në kullën qëndrore.

- 11.00 një grup nxënësish do të ketë një akt teatral mbi rëndësinë e monumenteve.
- 11.20 një grup studentësh do të aktivizojë një performancë ekzibicion për rëndësinë e pastrimit dhe mirëmbajtjes, me anën e lëvizjeve dhe ngjyrosjes.
- 12.00 mbyllja me formatin e një protokoll bashkëpunimi midis DRKK dhe DAR dhe Universitetit.

Pjesëmarrës do të jenë nxënës së shkollave – gjimnazet “Jordan Misja” dhe “28 nëntori”, studentë të universitetit të Shkodrës.

DREJTORIA RAJONALE E KULTURËS KOMBËTARE GJIROKASTËR

Aktiviteti do të zhvillohet me nxënës të shkolles 8-vjeçare "Koto Hoxhi" - Do të firmoset protokoli i bashkëpunimit midis DRKK-Gjirokastër dhe DAR-Gjirokastër për miqtë e monumenteve.

- Nxënësit do të marrin pjesë në pastrimin e territorit të kalasë.
- Vajtje në shtëpinë e Skëndulatëve, shtëpi e kategorisë së parë, një nga më të bukurat në rajon, në odën e së cilës do të zhvillohet një aktivitet njohës me trashëgiminë kulturore për nxënësit e qytetit.

DREJTORIA RAJONALE E KULTURËS KOMBËTARE KORÇË

Ky projekt do të zhvillohet në bashkëpunim me shkollat 9 -vjeçare në mbarë vendin dhe qëllimi kryesor i tij është të edukojë dhe te sensibilizojë gjeneratën e re për rëndësinë e trashëgimisë kulturore monumentale dhe arkeologjike.

Drejtorja Rajonale E Kulturës Kombëtare Korçë i bashkangjitet kësaj nisme duke organizuar aktivitetin sensibilizues “MIK I MONUMENTEVE”

Në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale Arsimore Korçë, 80 nxënës të shkollave 9-vjeçare do të zhvillojnë një vizitë njohjeje tek Bazilika e Linit – Pogradec si dhe do të bëhen protagonistë të pastrimit të territorit përreth kësaj Bazilike.

Trashëgimia Kulturore është themeli i rritjes së një gjenerate të shëndetshme dhe vizita në këto monumente do të sjellë jo vetëm njohjen e kësaj trashëgimie, por edhe vlerësimin dhe përkujdesjen që duhet të tregojmë ndaj tyre.

Ky projekt do të ketë startin e tij këtë 18 Prill 2014 por do të jetë starti i një sërë fushatash dhe projektesh që DRKK Korçë në bashkëpunim me DAR Korçë do të organizojë gjatë gjithë vitit dhe viteve në vazhdim.